



Këshilli i Mbikëqyrjes së institucioneve të vuajtjes së dënimeve penale

Çfarë është Këshilli i Mbikëqyrjes?

Këshilli i Mbikëqyrjes përbëhet nga persona që nuk punojnë në institucionet shtetërore, të cilët emërohen nga Ministria e Drejtësisë. Personat nuk kanë asnjë lidhje me institucionet e sistemit të vuajtjes së dënimeve penale dhe për këtë arsye nuk i nënshtrohen kompetencës urdhëruese të organeve të këtij sistemi. Këshilli i Mbikëqyrjes ka për detyrë, ndërmjet të tjerash, që të ushtrojë kontroll mbi institucionet e vuajtjes së dënimeve penale dhe të kontrollojë që të burgosurit trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, të flasë me të burgosurit mbi kushtet e vuajtjes së dënimit, dhe nëse të burgosurit japin pëlqimin e tyre, të shqyrtojë dokumentet e çështjeve të këtyre të burgosurve.

Ti mund të kontaktosh Këshillin e Mbikëqyrjes nëse ke pyetje ose je i pakënaqur me kushtet e vuajtjes së dënimit penal.

Si mund të kontaktosh Këshillin e Mbikëqyrjes?

Vizita të paparalajmëruara: Në rastet kur Këshilli i Mbikëqyrjes vjen për vizita të paparalajmëruara, të burgosurit do të njoftohen për këtë përmes sistemit të informacionit të brendshëm dhe/ose në ndonjë mënyrë tjetër. Në këtë rast, ti mund të shkruash emrin tënd në listën e personave që dëshirojnë të bisedojnë me Këshillin e Mbikëqyrjes. Institucioni i vuajtjes së dënimit ia dorëzon listën përfaqësuesve të Këshillit të Mbikëqyrjes.

Vizita të paralajmëruara: Në qoftë se Këshilli i Mbikëqyrjes njofton që më parë për vizitën e tij, atëherë, në njësitë/ seksionet e vuajtjes së dënimit do të vendosen lajmërimi me informacion mbi kohën dhe vendin e vizitës, si dhe mënyrën e regjistrimit për bisedë me përfaqësuesit e Këshillit të Mbikëqyrjes.

Kontakti përmes letrave: Ti mund të kontaktosh po ashtu, Këshillin e Mbikëqyrjes edhe përmes letrave. Letra vendoset në një zarf të mbyllur dhe i adresohet 'Tilsynsrådet'. Institucioni i vuajtjes së dënimit do t'ia përcjellë zarfin Këshillit të Mbikëqyrjes. Letrat që i dërgohen Këshillit të Mbikëqyrjes nuk i nënshtrohen kontrollit të institucioneve të sistemit të vuajtjes së dënimeve penale.

Kontakti përmes telefonit: Në qoftë se çështja është urgjente, ti mund të kontaktosh një nga anëtarët e Këshillit të Mbikëqyrjes përmes telefonit. Në këtë rast, duhet t'i drejtohesh një prej punonjësve të institucionit të vuajtjes së dënimit për të caktuar kohën e bisedës.

Çfarë ndodh më tej?

Çështjet që ti dëshiron të ndiqen nga Këshilli i Mbikëqyrjes, do të kërkohet që të zgjidhen së pari, në nivel lokal, domethënë përmes dialogut mes Këshillit të Mbikëqyrjes dhe drejtuesve të institucionit të vuajtjes së dënimit. Në qoftë se kjo nuk çon në zgjidhjen e çështjes ose Këshilli i Mbikëqyrjes e gjen të arsyeshme ta diskutojë çështjen me organin epror, atëherë Këshilli i Mbikëqyrjes ia parashtron çështjen organit rajonal të sistemit të vuajtjes së dënimeve penale.

Përfaqësuesit e Këshillit të Mbikëqyrjes janë të detyruar të respektojnë dispozitat e ligjit për administratën publike mbi ruajtjen e konfidencialitetit.